

NEWSLETTER E DIASPORËS

PËRFAQËSIMI DHE NXITJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE TË NDËRVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT,
DUKE NXITUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFIJVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPÉRISË DHE SHTETET KU ATA BANOJNË

#54

Miratohet Urdhri Nr. 53, datë 9.4.2020 "Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për rishikimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës dhe të Planit të Veprimit"

MINISTRI SHTETIT

PËR DIASPOREN



Me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Kryeministri i Republikës së Shqipërisë miraton urdhrin për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për rishikimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës dhe Planit të Veprimit, miratuar me Vendimin Nr. 259, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave. Grupi ndërinstitucional i punës kryesoitet nga ministri i Shtetit për Diasporën dhe në përbërje ka zëvendësministrat në ministrinë përgjegjëse për punët e jashtme, arsimin, financat, turizmin, punët e brendshme, drejtësinë, shëndetësinë, bujqësinë, kulturën; përfaqësues të ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes dhe Akademisë së Shkencave; dhe titulari i INSTAT-it Agjencisë Kombëtare të Diasporës. Propozimet e grupit ndërinstitucional të punës do të paraqiten për miratim brenda muajit qershor 2020.

Urdhri e plotë mund ta lexoni [këtu](#):

Publikohet "Buletini Mars 2020"

**PLANI I VEPRIMIT PER
ZBATIMIN E STRATEGJISE
KOMBËTARE TE
DIASPORES**


BULETIN

Nr. 1 Mars 2020

AGJENCIJA KOMBËTARE E DIASPORES

Ajencia Kombëtare e Diasporës ndjek zbatimin e masave të Planit të Veprimit nga institucionet përkatëse dhe informon çdo tre muaj publikun mbi securinë dhe procesin e zbatimit të masave të Planit të Veprimit, përmes publikimit të Buletinit. Publikimi i këtij dokumenti synon informimin e qytetarëve të interesuar brenda dhe jashtë vendit për securinë e politikave e masave shtetërore për Diasporën. Gjithashtu, Buletini informon anëtarët e strukturave vendimmarrëse lidhur me politikat, sukseset e arritura dhe vështirësitet e hasura gjatë zbatimit të reformës shtetërore për Diasporën. Buletinin e plotë, Mars 2020, mund ta lexoni [këtu](#):

Ndërhyrja e KKD – së, zgjidhet problem i shqiptarëve të mbetur në kufi



Pas deklaratës së Këshillit Koordinues të Diasporës, se do të mbështete finanziarisht periudhën e karantinës për 27 emigrantët e shqiptarë të bllokuar prej katër ditësh në pikën kufitare me Greqinë, pasditen e sotme ata kanë mbërritur në Korçë. Evakuimi u bë pas plotësimit të procedurave dhe kontrollit mjekësor, ndërsa shqiptarët u dërguan me automjetet e autoriteteve në një nga hotelet në qytetin e Korçës, ku do të qëndrojnë për 14 ditë në karantinë. Prej disa ditësh, 27 emigrantë në Kapshticë mbetën të bllokuar për shkak se pala shqiptare nuk i lejonte të kalonin në kufij në kuadër të masave kundër përhapjes së Covid-19. Por sot ashtu siç deklaroi edhe kryeministri Edi Rama është dhënë një zgjidhje për qytetarët. Tashmë ata janë transferuar për të qëndruar në karantinë në një hotel në Korçë. Kjo pas negociatave dhe marrjes përsipër të kostos, 14 ditë në hotel dhe ushqim 3 vaktet nga Këshilli Koordinues i Diasporës Shqiptare. Anëtarët e KKD-së e morën këtë vendim pasi Rama deklaroi se ata do futen në territorin tonë, vetëm nëse karantinohen 2 javë në struktura hoteliere me kostot e veta.

KKD / Mark Gjonaj flet për situatën e krijuar nga COVID-19



Mark Gjonaj, Kryetar i Këshillit Koordinues të Diasporës dhe njëkohësisht këshilltar i Bashkisë së New York-ut, flet për situatën dhe vështirësë e krijuara nga pandemia COVID-19 dhe për komunitetin shqiptaro-amerikan në New York. Ai shpreh ngushullimet e singerta për familjet e viktimate dhe lutet për pacientët e infektuar që po zhvillojnë betejën për jetën. Gjithashtu, si Kryetar i Komitetit për bizneset e vogla në bashki, z. Gjonaj tregon për ndikimin e krisës në bizneset e komunitetit shqiptar dhe mundësinë për të aplikuar për grante dhe kredi të ofruara nga qeveria federale.

KKD / Anila Hyka Smorgrav:

Shqiptarët t'i drejtohen selive diplomatike nëse duan që të rikthehen në atdhe



Nënkyetarja e Këshillit Koordinues të Diasporës, znj. Anila Hyka Smorgrav, nga Franca u bën thirrje të gjithë qytetarëve shqiptarë jashtë vendit për të mos lëvizin nga shteti në shtet gjetë kësaj situate dhe theksion se të gjithë shqiptarët që dëshirojnë të rikthehen në atdhe, duhet t'u drejtohen shërbimeve tonë diplomatike. Gjithashtu, ajo foli për situatën aktuale në Francë dhe masat e marra nga qeveria atje.

Lazim Destani, sqarim për vendimin e KKD - së




Lazim Destani, anëtar i Këshillit Koordinues të Diasporës dhe njëkohësisht President Nderi i Dhomës së Biznesit të Diasporës Shqiptare, sqaron mbi vendimin e marrë nga KKD, për t'u ofuar ndihmë shqiptarëve në pikën kufitare me Greqinë. Z. Destani theksion se, së bashku me anëtarët e tjerë të Këshillit, kanë mbuluar të gjithë shpenzimet e hotelit në Korçë, ku është bërë i mundur qëndrimi i tyre për 14 ditë. Gjithashtu, ai këshillon dhe inkurajon qytetarët të qëndrojnë në shtëpi dhe të vijojnë me zbatimin e masave të tjera për parandalimin e përhapjes së Covid-19.

Komunikatë e Këshillit Koordinues të Diasporës

Aplikacioni informues

"Diaspora Shqiptare"




App store [këtu](#) Play store [këtu](#)

Aplikacioni gazeta


"Diaspora Shqiptare"

SHKARKO
APLIKACIONIN FALAS




App store [këtu](#) Play store [këtu](#)

"Rapoço" problemi në çdo kohë në Ambasadalme



App store [këtu](#) Play store [këtu](#)

Komunikatë e Këshillit Koordinues të Diasporës



Komunikatë

06 Prill 2020

Si KKD jemi duke ndjekur me kujdes situatën e paprecedene të krijuar nga COVID-19 dhe jemi plotësisht të angazhuar me Komunitetin Shqiptar në vendet ku jetojmë në mënyrë që kjo situatë të kalojë sa më lehtë dhe me sa më pak pasoja.

Sa i përket shtetasve shqiptarë që duan të kthehen në vendindje, kemi komunikuar me qeverinë e cila na ka konfirmuar angazhimin e saj. Jemi të informuar se deri tanë janë riadheshuar të gjitha rastet emergjente.

Me shqetësim po ndjekim situatën e krijuar për shtetasit shqiptarë në pikat kufitare me Greqinë. I kemi kërkuar shtetit shqiptar që të marrë masa urgjente dhe t'u lejojë hyrjen në territorin shqiptar bashkëkombasive të bllokuar në zonën neutrale të kufit me Greqinë si dhe për të evitar një transmetim të mundshëm të virusit, të siguroj qëndrimin e tyre në izolim për një periudhë prej 14 ditësh brenda territorit të Shqipërisë. Për këtë, i kemi ofruar qeverisë shqiptare ndihmën tonë në mënyrë që kjo situatë të marri zgjidhjen e duhur sa më shpejt.

Në kushtet që ndodhemi, i bëjmë apel të gjithë bashkëkombasive tanë që përpëra se të vendosim për t'u kthyer në Shqipëri, të mirëinformohen pranë selive diplomatike apo Njësies së Emergjencës së Ministrisë së Punëve të Jashtme, informacionet e të cilës janë dhënë në faqen zyrtare:

<https://punetejashtme.gov.al/numrat-e-emergjencës-ne-mepj-dhe-te-perfagesive-se-rsh-se-ne-hote>

KKD bën thirrje që situata të tilla të mirëmenaxhohen nga konsulatatat dhe ambasadat e shtetit shqiptar duke i mirëinformuar dhe iu qëndruar më pranë shtetasve tanë.

Si KKD jemi totalisht të përkushtuar të ndihmojmë jo vetëm bashkëkombasit tanë, por edhe të kontrobojmë në menaxhimin e kësaj situatë të vështirë në vendindje. Për këtë arsy që jemi në kontakt me qeverinë në mënyrë që të gjemjë mekanizmat efikas për arritjen e ketij qëllimi.

Kjo situatë e paprecedente është sfidë për të gjitha shtetet, jo vetëm Shqipërinë, prandaj inkurajojmë të gjithë që t'a përkrahim njëri-tjetrin brenda mundësive në kapërcimin sa më të lehtë të situatës.

www.keshillikoordinuesdiasporas.com

KKD / Brikena Muharremi flet për situatën dhe vendimin e Këshillit



Anëtarja e Këshillit Koordinues të Diasporës, znj. Brikena Muharremi, në një intervistë, sqaron mbi vendimin e marrë nga Këshilli për t'u ofruar mbështetje shqiptarëve në kufi. Më tej, ajo flet dësht përshtatësitë aktuale dhe veprimtarinë e Këshillit, si organizimi i parë në historinë e shtetit shqiptar për të përfaqësuar interesat e Diasporës shqiptare.

